

***Press review - Visit of a CEPEJ delegation in the framework of the CEPEJ Court
Coaching Programme on the SATURN tools with the Tirana District Court***

17-20 January 2012

**Presentation of the CEPEJ work in Albania by Stéphane Leyenberger, Secretary of the
CEPEJ and Jacques Bühler, President of the Pilot Group of the SATURN Centre for
judicial time management**

Panorama newspaper

TIRANE – Ministria e Drejtësisë do të rishikojë numrin e gjyqtarëve në gjykatat e vendit, me qëllim rishpërndarjen e tyre në varësi të ngarkesës me dosje. Kjo rishpërndarje do të bëhet bazuar në pëlqimin e plotë të togave të zeza. Lajmi u bë i ditur dje nga ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi, gjatë fjalës së tij në një konferencë për “Përmirësimin e efikasitetit dhe funksionimin e drejtësisë”, mbajtur në ambientet e Ministrisë. “Jemi në një proces të rishikimit të përgjithshëm të numrit të gjyqtarëve në Shqipëri, duke bërë rishpërndarjen e tyre, bazuar në numrin e çështjeve për shqyrtim në gjykata, dhe jo në bazë të numrit të popullsisë apo territorit, duke rritur numrin e gjyqtarëve në ato gjykata, të cilat kanë një ngarkesë më të madhe, duke garantuar njëkohësisht transferimin e tyre, bazuar në pëlqimin e plotë”, u shpreh ministri Halimi para të pranishmëve. Në fjalën e tij, Halimi theksoi se dixhitalizimi i sistemit gjyqësor do të rrisë përgjegjshmërinë e aktorëve të sistemit të Drejtësisë. “Ne jemi duke përmirësuar sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore se bashku me misionin “Euralius”, me qëllim që të bëjmë transparente çdo hallkë të procesit, duke filluar nga shorti dhe deri në ekzekutimin e vendimeve”, tha Halimi. Në vijim, ai shtoi: “Ne do të implementojmë metodën e ‘audio recording’ në çdo rreth, në mënyrë që çdo fjalë, çdo gërmë, çdo veprim procedural të jetë lehtësisht i verifikueshëm. Synojmë të implementojmë brenda këtij viti edhe kamera-video në çdo sallë gjykimi, me qëllimin e vetëm për të garantuar një proces transparent gjyqësor dhe rritje të përgjegjshmërisë ndaj ligjit dhe Kushtetutës, si dhe rritjen e besimit të publikut tek drejtësia”. Komisioni Europian për Efikasitetin e Drejtësisë do të mbështesë Shqipërinë nëpërmjet një projekti pilot që do të zhvillojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Projekti ka si qëllim zhvillimin e disa mjeteve dhe masave që synojnë të përmirësojnë menaxhimin e kohës në gjykata sipas kriterëve dhe metodave optimale, duke ofruar mjete për zgjidhjen e problemit të afateve kohore të procedimeve gjyqësore. Të

pranishëm në konferencën e djeshme ishin kreu i Divizionit të Drejtësisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Stephane Leyenberger, përfaqësues të misionit “Euralius”, si edhe përfaqësues të sistemit gjyqësor shqiptar.

Gazeta Shqiptare newspaper

Ministri i Drejtësisë, Eduart Halimi, pranon korrupsionin dhe paaftësinë brenda sistemit të drejtësisë. Pa specifikuar emra konkretë, ministri Halimi ka akuzuar disa prej institucioneve të drejtësisë për përfshirje në korrupsion dhe lidhje me krimin. Gjate një takimi me përfaqësues të Komisionit Evropian dhe misionit EURALIUS, ministri Halimi deklaroi se me mbështetjen e tyre, këtë vit do të ketë ndryshime në sistemin e drejtësisë. Te gjithë gjyqtaret do të rishpërndahen në varësi të çështjeve dhe punës së tyre në gjykata. Në sallat e gjyqeve do të instalohen sistemet audio dhe kamerat për transparencë ndaj publikut, si dhe për të kontrolluar punën e gjyqtareve. Përfaqësuesit e Komisionit Evropian shprehen mbështetje për drejtësinë shqiptare.

Koha Jone

Leyenberger: Konsensus për reformat në drejtësi

Politikeberesit kanë përgjegjësinë për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, ndaj duhet të gjejnë konsensusin për ecurinë e reformave që sistemi të funksionojë si duhet. Kështu u shpreh dje, në një intervistë për gazetën “Koha Jone”, kryesuesi i delegacionit të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Stephane Leyenberger. Kreu i delegacionit tha se institucioni që ai përfaqëson, në këto kushte, do të punojë direkt me gjykatat pa qenë nevoja për ndërhyrjen e politikës, në nivel praktik për përmirësimin e punës së tyre. Leyenberger vlerësoi hapat që ka bërë Shqipëria në 10-vjeçarin e fundit, duke u shprehur se sistemi i drejtësisë është në rrugën e duhur. Nderkohe që keshilloi për luftë të vazhdueshme ndaj korrupsionit.

Zoti Leyenberger, pas takimeve të zhvilluara ditën e djeshme, sipas jush, ku duhet përmirësuar sistemi i drejtësisë në Shqipëri? Cilat janë pikat e dobëta të këtij sistemi?

Ka probleme të cilat janë të njëjta për vendet e Bashkimit Evropian. Disa janë në bllok për të gjitha vendet dhe të tjera janë specifike për secilin. Për rrjedhojë, të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, duhet të përmirësojnë sistemin e drejtësisë. Përsa i përket sistemit gjyqësor në Shqipëri, Shqipëria është një vend me një sistem ligjor pak a shumë të ri, sepse ju, para viteve 1990, nuk keni pasur një sistem gjyqësor të konsoliduar, çka do të thotë se e gjithë puna fillon pas vitit 1990, për të arritur në situatën e sotme. Duke u përqendruar në punën e tyre, CEPEJ-i, lidhur me kohezgjatjen e gjyqësorëve, Shqipëria është në një fazë që nuk ka as me shumë dhe as me pak probleme të vendit të tjerë. Pra, çështja vështirohet për sa i përket kohezgjatjes së gjyqësorëve, është mirë përsa i përket Gjykatës së Shkallës së Parë, por vjen duke u vështirësuar për sa i përket Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Është e vështirë për ta shpjeguar se cila është arsyeja, nuk kam një shpjegim se pse ndodh kështu. Megjithatë, në të vërtetë unë jam i befalshëm nga progresi që

eshte bere ne vendin tuaj pas viteve 1990 e deri me sot. Sigurisht qe ka probleme, ashtu si edhe ne vendet e tjera, por jam shume i sigurt se drejtesia eshte duke funksionuar si nje proces normal. Keshtu, gjyqtaret vendosen ne detyre, pasi kane perfunduar Shkollen e Magjistratures dhe niveli i aftesive ka ardhur duke u permiresuar. Nga ana tjetere, sistemi i teknologjise se informacionit eshte duke funksionuar qe nga gjykatat. Po ashtu, shikojme qe ceshtjet shqyrtohen ne gjykata dhe kuadri ligjor funksionon. Pra, kemi kaluar nga nje periudhe problematike qe eshte normale ne tranzicion, ne nje periudhe ku drejtesia funksionon normalisht. Por kjo nuk do te thote se cdo gje funksionon me se miri dhe problemet jane zgjidhur teresisht. Por problemet jane normale dhe qe jane hasur ne te gjitha vendet anetare. Kam parasysh sistemin e tanishem te sistemit te drejtesise. Pra, nuk do te thote se nuk ka probleme me korrupsionin apo ne lidhje me menyren e funksionimit e ceshtjeve dhe roli i CEPEJ-it eshte te perqendroje punen e tij, per te permiresuar funksionimin e drejtesise ne menyre te pergjithshme.

Cilat jane fushat kryesore ku ju do te perqendrohemi ne bashkepunimin dhe reformimin e sistemit te drejtesise ne Shqiperi?

Ne menyre specifike, ne do te punojme sot ne Gjykatën e Tiranës, Shkollën e Për. Se fundmi, Gjykata e Tiranës i është shtuar listës së gjykatave “pilot”, pra që do të thotë që do të bashkëpunojmë në nivel të caktuar në këto gjykata. Ne shpresojmë që të kemi mundësi që ta shpërndajmë metodologjinë e punës edhe në gjykata të tjera. Në menyre më specifike në Gjykatën e Tiranës, do të punojmë për zbatimin e atyre mjeteve që kanë të bëjnë me menaxhimin e çështjeve gjyqësore, për të sugjeruar se si mund të bëhet më mirë puna në gjykata, pa qenë e nevojshme të behen ndryshime në legjislacion. Duke u nisur nga kjo, ne shpresojmë të permiresojmë me shume këto bashkëpunim. Pra të mos qendrojmë vetëm në nivelin e politikeberesve, pra Ministrisë së Drejtësisë apo KLD-së. Pra është mirë që të punohet direkt me aktoret e kësaj pune, pra gjykatat. Ky dialog direkt, që vendoset mes Këshillit të Evropës dhe gjykatës, e bën më të mirë këto bashkëpunim. Sot, funksionimi i sistemit të drejtësisë është pjesërisht punë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Parlamentit, që merren me kuadrin legjislativ dhe gjithashtu, shteti duhet të bëjë të mundur zbatimin e mjeteve të duhura për permiresimin e sistemit të drejtësisë. Pergjegjësia, pra, ndahet mbi vete gjyqtarët dhe aktoret e perditshem që merren me drejtësinë.

Ne fakt, shume projektligje qe lidhen me reformen e drejtesise kane ngecur prej 2 vitesh ne Kuvend, per shkak te mungeses se konsensusit dhe bojkotit te opozites. A mund te ndikojte kjo ne kete reforme?

Një pjesë e pergjegjësise, sigurisht, që bie mbi politikeberesin, në lidhje me permiresimin e sistemit të drejtësisë. Kjo i perket jetës politike dhe jetës demokratike në një vend. Normalisht, gjeja më e mirë do të ishte që ky sistem të funksiononte si duhet, por këto janë probleme që hasen në vende demokratike. Por pavarësisht këtyre problemeve, në nivel politikeberesjeje, CEPEJ-i e ka aftësinë të punojë drejtperdrejt me gjykatat, pa qenë e nevojshme nderhyrja e politikës. Puna jone do të perqendrohet në nivel praktik, si organizohen punët në gjykata. Kjo mund të permiresohet. Por unë inkurajoj faktin që Ministria

e Drejtesise dhe Parlamenti, ndoshta, mund te gjejne zgjidhje. Udhezimet tona mund ta ndihmojne edhe klimen politike, por gjithsesi keto mbeten ne sovranitetin e Parlamentit.

Cfare do te keshillonit konkretisht, per permiresimin e sistemit te drejtesise ne Shqiperi?

Ne inkurajojme te gjitha aktoret shqiptare qe te marrin te gjitha masat e duhura dhe mjetet qe duhen ne luften kunder korrupsionit. Ne dekadën e fundit jane bere shume perpjekje. Ka nje kuader ligjor qe eshte shume efektiv. Objektivi kryesor per t'ua zbatuar eshte, ne radhe te pare, lufta kunder korrupsionit. Kjo duhet mbajtur parasysh nga te gjithë: Ministria e Drejtesise, Prokuroria, Keshilli i Larte i Drejtesise, gjyqtaret, etj. Edhe pse jane bere shume perpjekje, kjo eshte si nje histori qe nuk mbaron dhe qe duhet mbajtur gjithnje parasysh. Nje tjetër sugjerim qe do te jepja ne emer te Keshillit te Evropes, eshte dhenia e mjeteve te duhura financiare per sistemin e drejtesise qe te funksionojë. Buxheti i duhur per sistemin gjyqesor duhet te jete nje nga prioritetet e ardhshme. Nje nga prioritetet kryesore te Keshillit te Evropes, eshte qe te punoje me shtetet e tij anetare. Po te krahasojme situaten e para dhjete viteve me situaten e sotme, rritja eshte e konsiderueshme.

Euralius Website

On 18 January 2012 EURALIUS III, Ministry of Justice, and Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) organized the conference "Improving the efficiency and functioning of justice in member states-Albania as a particular case". In this event participated high ranking officials of the Ministry of Justice, judges of all Albanian courts (first instance and appeal), prosecutors, court chancellors, professors from the School of Magistrates, enforcement agents and representatives from international organizations.

Minister of Justice Mr Eduard Halimi in his speech considered the role of the CEPEJ as pivotal for Albanian justice system and the expertise offered by CEPEJ experts will help the justice actors through appropriate solutions and contemporary tools.

The aim of the CEPEJ is to improve the efficiency and functioning of justice in the member States, and the development of the implementation of the instruments adopted by the Council of Europe.

Mr Stephane Leyenberger, Acting Head of the Justice Division, Secretary to the CEPEJ, Mr Jacques Buhler, Expert to the CEPEJ and member of the Supreme Court of Switzerland and Mr Julien Lhuillier, Expert at EURALIUS made a detailed presentation of the CEPEJ and its role in the justice system of the member states of the Council of Europe (CoE). CEPEJ in close collaboration with different courts the member states of the Council of Europe assist them by elaborating specific tools to improve the work organization in the day to day practice. The conference was designated to give to the audience a full overview on tools of CEPEJ as: Evaluation report of European judicial systems, CEPEJ guidelines on judicial statistics (GOJUST), Time management checklist and SATURN guidelines for judicial time management. Experts of the CEPEJ introduced

also the checklist for promoting the quality of justice in the courts and handbook for conducting satisfactory surveys for court users.

The experts of CEPEJ and EURALIUS will be of continuous assistance to Tirana District Court as a pilot court to find better practices to ameliorate the work organization and to optimize the length of proceedings.

Website of the Ministry of Justice



European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) supports the Ministry of Justice for the improvement of quality and efficiency of the justice system

The European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) will support the Ministry of Justice to find new methods and practices in order to improve the quality and efficiency of the justice system and strengthen the trust of the public in courts.

The conference on “Improvement of efficiency and functioning of justice in member states – Albania as a concrete case” was held today at the Ministry of Justice, in cooperation with the European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), EURALIUS Mission, Council of Europe Office in Tirana, in which senior officials of these institutions agreed for the implementation of projects assisting the national justice system.

The European Commission for the Efficiency of Justice will support Albania through a pilot project it will conduct at Tirana District Court. The project aims at the development of some instruments and measures intended to improve the time management at courts, according to optimal criteria and methods, offering means for the solution of the issue of judicial proceeding time limits.

On this occasion the Minister Halimi declared: “Introduction and use of Information Technology in the justice system, particularly in the administration of work at courts, as well as the computerization of justice system data, in order to provide a service closer to the citizen, requires not only the establishment of new practices but also the selection of the suitable means or the adoption of new instruments. In this regard, it is satisfied that only CEPEJ may offer precious expertise which may serve as an example to be followed for the accomplishment of our mission to optimally render and guarantee justice in accordance with the EU standards and recommendations in the field of justice and court administration”.

Digitalization of the judicial system for the purpose of the enhancement of this system’s

performance; increase of accountability of the justice system stakeholders; making each chain of the process transparent, starting from the lot drawing procedure until the enforcement of decisions are some of the priorities of the Ministry of Justice.

A high delegation of the European Commission for the Efficiency of Justice, led by Mr. Stéphane LEYENBERGER, Head of the Justice Division and CEPEJ Secretary has visited Albania for the first time.

The European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) was set up in 2002, upon the initiative of the Committee of Ministers of Justice of the Council of Europe as a new institution for the improvement of quality and efficiency of the justice system in each member country and strengthening of the trust of court users in these systems.

It helps member states to render justice fairly and rapidly; it drafts concrete measures and recommendations related to the policy drafters and judicial practitioners; it analyzes the functioning of the judicial systems and guides public policies of justice.

Its mission is :

- to propose pragmatic solutions in respect of the judicial organization, taking into consideration the court users;
- to ensure a better implementation of the Council of Europe Standards in the field of justice;
- to contribute to the facilitation of the caseload at the European Court of Human Rights, providing the states with effective solutions to prevent violations of the right to fair trial within a reasonable time limit (Article 6 of the European Convention of Human Rights).

The promotion of quality of the public service of justice; implementation of the European standards (access to justice, enforcement of court decisions, mediation etc) as support of the member states to their reforms in the organization of Courts, are issues in terms of which the European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) will support Albania.

[Opening speech of the Minister of Justice](#)

KE mbështet Ministrinë e Drejtësisë në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë

Halimi: Transparenca në gjykata, projekti do të realizohet brenda vitit

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) do të mbështesë Ministrinë e Drejtësisë në gjetjen e metodave dhe praktikave të reja për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë si dhe për të forcuar besimin e publikut tek gjykatat

Në Ministrinë e Drejtësisë në bashkëpunimin me Komisionin Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Misionin EURALIUS, Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë u mbajt dje konferenca për "Përmirësimin e efikasitetit dhe funksionimit të drejtësisë në shtetet anëtare - Shqipëria si rast konkret" në të cilën titullare të lartë të këtyre institucioneve ranë dakord për zhvillimin e projekteve që ndihmojnë sistemin e drejtësisë në vend. Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë do të mbështesë Shqipërinë nëpërmjet një projekti pilot që do të zhvillojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Projekti ka si qëllim zhvillimin e disa mjeteve dhe masave që synojnë të përmirësojnë menaxhimin e kohës në gjykata sipas kriterëve dhe metodave optimale duke ofruar mjete për zgjidhjen e problemit të afateve kohore të procedimeve gjyqësore. Me këtë rast Ministri Halimi deklaroi se "Fuqja dhe përdorimi i Teknologjisë së Informacionit në sistemin e drejtësisë, dhe veçanërisht në administrimin e punës në gjykata, si kundër edhe informaticizimi i të dhënave të sistemit të drejtësisë, në mënyrë që të ofrojë një shërbim sa më pranë qytetarit, lërkon jo vetëm krijimin e praktikave të reja, por edhe zgjidhjen e mjeteve të përshtatshme apo adoptimin e instrumenteve të reja, për të cilat shpreh bindjen se vetëm CEPEJ-i, mund të ofrojë një ekspertizë të gmuar që mund të shërbejë si shembull për t'u ndjekur në përbushjen e misionit tonë për të ofruar dhe garantuar një drejtësi në përputhje me standardet dhe me rekomandimet e BE në fushën e drejtësisë dhe të administrimit të gjykatave në mënyrë optimale.", deklaroi Ministri Halimi në fillim mbajtur me këtë rast. Sipas tij brenda këtij viti në gjykata shqiptare do të implementohen kamera-video në çdo sallë gjyqësore në mënyrë që çdo gjë, çdo gjë që bëhet dhe në ambientet e gjykatës për të parë mënyrën se si veprojnë gjykatat shqiptare.



"Vlen të përmendet fakti që për herë të parë, në Gjykatën e Rrethit të Tiranës do të zbatohet projekti i qendrës Saturn, i parashikuar brenda kuadrit të Cepej-it, i cili do të ndihmojë gjykatat në miradministrimin e kohës së punës, sipas kriterëve dhe metodave optimale duke ofruar mjete për zgjidhjen e problemit të afateve kohore të procedimeve gjyqësore", vlerësoi ministri i Drejtësisë, Eduart Halimi

"Në këtë aspekt, vlen të përmendet fakti që për herë të parë, në Gjykatën e Rrethit të Tiranës do të zbatohet projekti i qendrës Saturn, i parashikuar brenda kuadrit të Cepej-it, i cili do të ndihmojë gjykatat në miradministrimin e kohës së punës, sipas kriterëve dhe metodave optimale duke ofruar mjete për zgjidhjen e problemit të afateve kohore të procedimeve gjyqësore", vlerësoi ministri i Drejtësisë, Eduart Halimi. Regjistrimi i seancave gjyqësore dhe monitorimi i gjyqtarëve kanë për qëllim garantimin e një procesi transparent gjyqësor dhe rritje të përgjegjshmërisë ndaj ligjit dhe Kushtetutës si dhe rritjen e besimit të publikut tek drejtësia. Sistemi do të monitorohet nga inspektorët e Ministrisë

e Drejtësisë dhe KLD-së në një sallë operative të përbashkët të vendosur në këto dy institucione. Digiditalizimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e përfomancës së këtij sistemi: rritjen e përgjegjshmërisë së aktorëve të sistemit të drejtësisë; bërjen transparente të çdo halli të procesit, duke filluar nga shorti dhe deri në ekzekutimin e vendimeve janë disa nga prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë. Një delegacion nga Mir Stéphane LEVENBERGER, Kreu i Divizionit të Drejtësisë dhe Sekretar i CEPEJ po viziton Shqipërinë për herë të parë në vend. Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) është ngritur në vitin

2002, me iniciativën e Komitetit të Ministrave Drejtësisë të Këshillit të Evropës si një institucion i ri për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë në secilin vend anëtar dhe forcimin e besimit të përdoruesve të gjykatës në këto sisteme. Ai ndihmon shtetet anëtare për të dhënë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë; harton masa konkrete dhe rekomandime që lidhen me hartuesit e politikave dhe praktikuesit gjyqësor; analizon funksionimin e sistemeve gjyqësore dhe orienton politikën publike të drejtësisë. Misioni i tij është: të propozojë zgjidhje pragmatike shteteve sa i përket organizimit gjyqësor, duke pasur parasysh përdoruesit e gjykatave; të mundësojë një zbatim më të mirë të Stan-

dardëve të Këshillit të Evropës në fushën e drejtësisë; të kontribuojë në lehtësimin e ngarkesës së qytetare në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, duke i siguruar shteteve zgjidhje efektive për të parandaluar shkeljet e të drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm (Neni 6 i Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut). Nxitja e cilësisë së shërbimit publik të drejtësisë; zbatimi i standardeve Evropiane (aktesi në drejtësi, ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, ndërmjetësimi, etj) si mbështetje e shteteve anëtare në reformat e tyre në organizimin e Gjykatave janë qëshjet në të cilat Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë CEPEJ do të mbështesë Shqipërinë.

Ambasada franceze dhuron pajisje teknike për Departamentin kundër krimit te organizuar

Nga Ambasada Franceze, u dhuruan dje disa pajisje teknike Policisë së Shtetit, të cilat do t'i shërbejnë strukturave të Departamentit kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rëndta, përkatësisht Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale. Në ceremoninë e castit të zhvilluar në ambientet e kësaj ambasade, ishin të pranishëm Ambasadorja Franceze, Zj. Christine Moro, Zv/Drejtori i Përgjithshëm kundër Krimit të Organizuar e Krimeve të Rëndta, Z. Ibën Vocaj, si dhe Drejtori i Forcës së Posaçme Operacionale, Z. Nikolin Bala. Z. Kulliqaj duhe falenderuar Ambasadorën Franceze, për mbështetjen e vazhdueshme dhënë strukturave të Policisë së Shtetit si në drejtim të trajnimit, ashtu edhe me mbështetje në logjistikë, i vlerësoi tepër të rëndësishme pajisjet e dhuruara sot për strukturat që Ai drejton. "Këto pajisje do të ndikojnë në rritjen e kapaciteteve profesionale të strukturave të këtij Departamenti, për të qenë edhe më të suksesshme në hetimin dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale dhe luftën ndaj krimit të organizuar", evidentoi Z. Kulliqaj. Ndërkohë, Zj. Christine Moro, theksoi se përmes dhurimit të këtyre pajisjeve Ambasada Franceze synon të ndihmojë punonjësit e policisë në përbaljen e tyre me krimin. Po ashtu Zj. Moro vlerësoi ecurinë e bashkëpunimit shumë të mirë dypalësh dhe evidentoi nevojën e thellimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në të ardhmen.



Halimi: Rishikim shpërndarjes së gjyqtarëve nëpër gjykata

Publikuar më 2012-01-19 12:21:15

TIRANE – Ministria e Drejtësisë do të rishikojë numrin e gjyqtarëve në gjykatat e vendit, me qëllim rishpërndarjen e tyre në varësi të ngarkesës me dosje. Kjo rishpërndarje do të bëhet bazuar në pëlqimin e plotë të togave të zeza. Lajmi u bë i ditur dje nga ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi, gjatë fjalës së tij në një konferencë për "Përmirësimin e efikasitetit dhe funksionimin e drejtësisë", mbajtur në ambientet e Ministrisë. "Jemi në një proces të rishikimit të përgjithshëm të numrit të gjyqtarëve në Shqipëri, duke bërë rishpërndarjen e tyre, bazuar në numrin e çështjeve për shqyrtim në gjykata, dhe jo në bazë të numrit të popullsisë apo territorit, duke rritur numrin e gjyqtarëve në ato gjykata, të cilat kanë një ngarkesë më të madhe, duke garantuar njëkohësisht transferimin e tyre, bazuar në pëlqimin e plotë", u shpreh ministri Halimi para të pranishmëve. Në fjalën e tij, Halimi theksoi se



Ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi

dixhitalizimi i sistemit gjyqësor do të risë përgjegjshmërinë e aktorëve të sistemit të Drejtësisë. "Ne jemi duke përmirësuar sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore se bashku me misionin "Euralius", me qëllim që të bëjmë transparente çdo hallkë të procesit, duke filluar nga shorti dhe deri në ekzekutimin e vendimeve", tha Halimi. Në vijim, ai shtoi: "Ne do të implementojmë metodën e 'audio recording' në çdo rreth, në mënyrë që çdo fjalë, çdo gërmë, çdo veprim procedural të jetë lehtësisht i verifikueshëm. Synojmë të implementojmë brenda këtij viti edhe kamera-video në çdo sallë gjyqësore, me qëllimin e vetëm për të garantuar një proces transparent gjyqësor dhe rritje të përgjegjshmërisë ndaj ligjit dhe Kushtetutës, si dhe rritjen e besimit të publikut tek drejtësia". Komisioni European për Efikasitetin e Drejtësisë do të mbështesë Shqipërinë nëpërmjet një projekti pilot që do të zhvillojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Projekti ka si qëllim zhvillimin e disa mjeteve dhe masave që synojnë të përmirësojnë menaxhimin e kohës në gjykata sipas kritereve dhe metodave optimale, duke ofruar mjete për zgjidhjen e problemit të afateve kohore të procedimeve gjyqësore. Të pranishëm në konferencën e djeshme ishin kreu i Divizionit të Drejtësisë së Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë ([CEPEJ](#)), Stephane Leyenberger, përfaqësues të misionit "Euralius", si edhe përfaqësues të sistemit gjyqësor shqiptar. ar.ba



Halimi: Rishikim shpërndarjes së gjyqtarëve nëpër gjykata

Ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi TIRANE – Ministria e Drejtësisë do të rishikojë numrin e gjyqtarëve në gjykatat e vendit, me qëllim rishpërndarjen e tyre në varësi të ngarkesës me dosje. Kjo rishpërndarje do të bëhet bazuar në pëlqimin e plotë të togave të zeza. Lajmi u bë i ditur dje nga ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi, gjatë fjalës së tij në një konferencë për "Përmirësimin e efikasitetit dhe funksionimin e drejtësisë", mbajtur në ambientet e Ministrisë. "Jemi në një proces të rishikimit të përgjithshëm të numrit të gjyqtarëve në Shqipëri, duke bërë rishpërndarjen e tyre, bazuar në numrin e çështjeve për shqyrtim në gjykata, dhe jo në bazë të numrit të popullsisë apo territorit, duke rritur numrin e gjyqtarëve në ato gjykata, të cilat kanë një ngarkesë më të madhe, duke garantuar njëkohësisht transferimin e tyre, bazuar në pëlqimin e plotë", u shpreh ministri Halimi para të pranishmëve. Në fjalën e tij, Halimi theksoi se dixhitalizimi i sistemit gjyqësor do të rrisë përgjegjshmërinë e aktorëve të sistemit të Drejtësisë. "Ne jemi duke përmirësuar sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore se bashku me misionin "Euralius", me qëllim që të bëjmë transparente çdo hallkë të procesit, duke filluar nga shorti dhe deri në ekzekutimin e vendimeve", tha Halimi. Në vijim, ai shtoi: "Ne do të implementojmë metodën e 'audio recording' në çdo rreth, në mënyrë që çdo fjalë, çdo gërmë, çdo veprim procedural të jetë lehtësisht i verifikueshëm. Synojmë të implementojmë brenda këtij viti edhe kamera-video në çdo sallë gjykimi, me qëllimin e vetëm për të garantuar një proces transparent gjyqësor dhe rritje te përgjegjshmërisë ndaj ligjit dhe Kushtetutës, si dhe rritjen e besimit të publikut tek drejtësia". Komisioni European për Efikasitetin e Drejtësisë do të mbështesë Shqipërinë nëpërmjet një projekti pilot që do të zhvillojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Projekti ka si qëllim zhvillimin e disa mjeteve dhe masave që synojnë të përmirësojnë menaxhimin e kohës në gjykata sipas kriterëve dhe metodave optimale, duke ofruar mjete për zgjidhjen e problemit të afateve kohore të procedimeve gjyqësore. Të pranishëm në konferencën e djeshme ishin kreu i Divizionit të Drejtësisë së Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Stephane Leyenberger, përfaqësues të misionit "Euralius", si edhe përfaqësues të sistemit gjyqësor shqiptar.

ar.ba

Burimi i lajmit: [Panorama ONLINE » Kronike](#).